

QASJA PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË NDËRTESAT SHUMËBANESORE NË PRISHTINË

Raporti i hulumtimit të shkallës së qasshmërisë në
hapësirat e përbashkëta të ndërtesave
shumëbanesore në Prishtinë

QASJA PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË NDËRTESAT SHUMËBANESORE NË PRISHTINË

**Raporti i hulumtimit të shkallës së qasshmërisë në
hapësirat e përbashkëta të ndërtesave
shumëbanesore në Prishtinë**

Autore: Rozafa Basha, arkitekte

Asistentë hulumtimi: Lendrit Krasniqi & Lirigzon Olluri
(studentë të programit Master në Fakultetin e Arkitekturës,
Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina')

*Të gjitha fotografitë dhe shembujt grafikë të përdorur në raport janë në autorësi të:
Rozafa Basha, Lendrit Krasniqi dhe Lirigzon Olluri

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Rr.Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
10000 Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Ky hulumtim është realizuar nga EC Ma Ndryshe si pjesë e Aleancës
për Qytetari Aktive në kuadër të programit – "Aleanca për Qytetari
Aktive dhe Komuna Përgjegjëse, financuar nga Olof Palme International
Center mbështetur nga Qeveria e Suedisë.



Prizren, dhjetor 2022

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive

2

Sfondi i problemit

5

Përkufizimet kryesore

5

Aftësia e kufizuar

5

Qasshmëria/ Arritshmëria

6

Barrierë arkitektonike

6

Modelet e aftësisë së kufizuar dhe mjedisi i ndërtuar

6

Dokumentet kryesore udhëzuese ndërkombëtare dhe kombëtare

7

Dokumentet kryesore ndërkombëtare

8

Ligjshmëria dhe dokumente kombëtare

9

Metodologjia e hulumtimit

16

Vlerësimi i parametrave themelorë të qasjes

20

Elementet themelore qasëse në ndërtesa

20

Parkingu për persona me aftësi të kufizuara

20

Rampa

20

Qasja brenda ndërtesës - gjerësia e hyrjes dhe erëmbrojtësi

21

Hapësira e përbashkët e jashtme e ndërtesës

22

Hapësira e brendshme e përbashkët e ndërtesës

24

Konkludim

27

Rekomandimet

28

Rekomandimet e përgjithshme

28

Rekomandime grafike për zgjidhjet teknike të problemeve më kritike të hasura gjatë hulumtimit

Parkingjet e qasshme për persona me aftësi të kufizuara

30

Rampa

31

Ashensorët

33

Hyrja në ndërtesë dhe erëmbrojtësi

35

Korridoret e ndërtesës shumëbanesore

36

Praktika të mira të përshtatjes së mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm për qasje të personave me aftësi të kufizuara

37

Akronimet

- (EU) Acquis** Përmbledhje e të drejtave dhe obligimeve që e konstituojnë trupin ligjor të BE-së
- BE** Bashkimi Evropian
- GIZ** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (Agjencia Gjermane e Zhvillimit)
- KKBDPAK** Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- MASHT** Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Teknologjisë
- MIA** Ministria e Infrastruktës dhe Mjedisit
- MMPH** Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
- MPMS** Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale
- MSH** Ministrisë së Shëndetësisë
- OBSh** Organizata Botërore e Shëndetësisë
- OJQ** Organizatë Jo Qeveritare
- PAK** Persona me Aftësi të Kufizuara
- SDG** (ang.) Sustainable Development Goals (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm)
- UA** Udhëzimi Administrativ

Përmbledhja ekzekutive

Raporti 'Qasja për Persona me Aftësi të Kufizuara në Ndërtesat Shumëbanesore në Prishtinë' përmbledh rezultatet e investigimit të qasshmërisë së hapësirave të përbashkëta në një përzgjedhje të kufizuar të ndërtesave shumë- banesore, të banimit social dhe banimit për studentë në qytetin e Prishtinës. Mungesa e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në mjedisin e ndërtuar në kontekstin kosovar vazhdon të jetë problem akut, përkundër presionit të organi- zatave të shoqërisë civile dhe të aftësisë së kufizuar, si dhe mbi të gjitha, përkundër ekzistencës së një dokumenti ligjor, i cili përcakton normat e eliminimit të barrierave arkitektonike nga mjedisi i ndërtuar.¹

Sipas Organizatë Botërore të Shëndetësisë (OBSh), aftësia e kufizuar është pjesë e pandashme e përvojës njerëzore, të cilën, heret a vonë, do ta përjetojë secili nga ne, qoftë për kohë të shkurtër apo si përvojë të përhershme. Sipas të dhënave në platformat online të kësaj organizate, por edhe të Bankës Botërore, sot janë rreth 1.3 miliard njerëz që janë duke e eksperiencuar ndonjë formë të aftësisë së kufizuar. Ndërsa sipas një vlerësimi të Bankës Botërore, një e pesta e vlerës së sipërpërmendur (prej 110.000.000–190.000.000 njerëz) kanë aftësi të kufizuar të një shkalle të theksuar. Pjesa tjetër e popullsisë përballen me probleme të përkohshme për shkak të lëndimeve a dëmtimeve nga aksidentet, sëmundjet apo ndonjë situatate tjetër kufizuese. Kjo organizatë, në përkufizimin që ia bën aftësisë së kufizuar, thekson se ajo nuk është vetëm problem shëndetësor, por është edhe fenomen kompleks që reflekton ndërveprimin ndërmjet tipareve të trupit të një njeriu dhe tipareve të një shoqërie, në të cilën ai njeri jeton.

Në Kosovë, nuk ekziston një statistikë përmbledhëse, që jep saktë numrin e personave me aftësi të kufizuara në nivel vendi, meqë edhe nga regjistrimi i fundit të popullsisë nuk kemi ndonjë të dhënë të besueshme. Por, bazuar në raportet e organizatave të aftësisë së kufizuar, llogaritet që edhe në Kosovë, popullsia me aftësi të kufizuar duhet të jetë e një përqindjeje të ngjashme me atë në nivel global.

¹ I vetmi dokument ligjor në fuqi në legjislacionin kosovar, që rregullon eliminimin e barrierave arkitektonike nga mjedisi i ndërtuar është Udhëzimi Administrativ, 33/ 2007, Për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, me bazë në Ligjin (tashmë të shfuqizuar) e Ndërtimit, 2004/15

Në dekadën e fundit ka patur shumë përpjekje për të evidentuar situatën e mjedisit të ndërtuar të paqasshëm në qytetet e Kosovës. Në veçanti është punuar mjaft në evidentimin të barrierave në ndërtesa publike dhe hapësira publike në qytetin e Prishtinës. Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile vazhdimisht avokojnë në drejtim të vetëdijesimit të shoqërisë mbi faktin se mjedisi i ndërtuar përplot barrierat arkitektonike është një faktor i rëndësishëm i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara dhe pengesë madhore në luftimin e pabarazive shoqërore. Por, të gjitha këto përpjekje nuk është se kanë sjellë ndonjë rezultat madhor në eliminimin e barrierave arkitektonike nga qytetet që i jetojmë. Barrierat arkitektonike në hapësirë dhe ndërtesa publike vazhdojnë të jenë faktori përjashtues dhe izolues i personave me aftësi të kufizuara nga pjesa tjetër e shoqërisë, si dhe faktori kryesor që ata i mban larg shkollimit, punës dhe pavarësisë ekonomike.

Deri më tani nuk është bërë një auditim i gjerë i qasshmërisë së ndërtesave shumëbanesore, që momentalisht akomodojnë pjesën më të madhe të popullësisë në qytetin e Prishtinës. Janë bërë disa përpjekje të organizatave të aftësisë së kufizuar që të vlerësohet qasshmëria e disa ndërtesave që banohen nga disa persona me aftësi të kufizuara, me qëllim që problemet e evidentuara të dërgohen si kërkesa në Komunën e Prishtinës për përmirësimin e qasjes për këta banorë. Shumë pak është intervenuar në përmirësimin e këtyre problemeve. Intervенimet e rralla përmirësuese, me qëllim të rritjes së qasjes së personave me aftësi të kufizuara në këto ndërtesa, janë kryesisht rezultat i përpjekjeve dhe investimeve private të familjarëve të banorëve me aftësi të kufizuara, ose intervenime modeste komunale të ndihmuara nga donacionet ndërkombëtare përmes organizatave të aftësisë së kufizuar.

Është më se e evidente se prania e barrierave arkitektonike të hapësirave të përbashkëta të ndërtesave kolektive rezultojnë me izolimin shtëpiak të personave me aftësi të kufizuara, pra, ua kufizon lëvizjen e lirë dhe kryerjen e detyrave të përditshme. Të njëjta pengesa në hapësirat e përbashkëta të objekteve të banimit kolektiv, mbajnë të izoluar edhe të moshuarit, si dhe ua vështirësojnë lëvizjen prindërve me fëmijë të vegjël, shtatëzënave apo të sëmurëve. Përballja e personave me aftësi të kufizuara me këto barrierat në ndërtesa banimi, por edhe fasha e gjerë e popullësisë e prekur nga to, shpërfaqin seriozitetin e kësaj problematike.

Të gjitha këto, i dhanë shkas këtij hulumtimi të shkurtër, i cili nuk pretendon të japë një pasqyrë të plotë të situatës dhe shkallës së qasshmërisë së ndërtesave të banimit kolektiv në Prishtinë. Por, përmes shpalosjes së shpeshtësisë, llojeve dhe formave të barrierave arkitektonike të pranishme në këto tipologji ndërtime, synohet që të aktualizohet problematika e mungesës së qasjes për persona me aftësi të kufizuara në hapësirat e përbashkëta në ndërtesa banimi.

Raporti po ashtu, synon të ofrojë rekomandime të përgjithshme dhe disa rekomandime për zgjidhjet teknike për eliminimin e barrierave arkitektonike në këto ndërtesa.

Investigimi në këtë raport, përdor metodologjinë e vlerësimit që është hartuar duke u bazuar në ligjin në fuqi, Udhëzimin Administrativ 33/2007. Ndërtesat e hulumtuara janë ato që janë ndërtuar para vitit 1999 dhe ato të dhjetëvjetshave të fundit dhe përfshijnë të gjitha lagjet e mëdha të Prishtinës. Disa nga ndërtesat e hulumtuara janë të banuara me persona me aftësi të kufizuara (lista e këtyre personave është siguruar duke kontaktuar organizata të aftësisë së kufizuar), ndërsa vlerësimi i të tjerave është caktuar përmes një përzgjedhjeje të rëndomtë. Për të kompletuar pasqyrën e qasshmërisë të të gjitha tipologjive të banimit kolektiv, janë vlerësuar edhe ndërtesa e banimit social dhe konvikte të studentëve.

Rezultatet e vlerësimit të këtyre ndërtesave tregojnë një shumësi barrierash arkitektonike sikur tek ndërtesat e ndërtuara para vitit 1999 ashtu edhe tek të rejat. Barrierat e hasura janë të panumërta në të shumtën e rasteve për persona me aftësi të kufizuara fizike, por të shumëta edhe për persona të verbër dhe ata me shikim të dëmtuar. Ato paraqiten qysh në hapësirën e hapur përreth ndërtesave, në hyrje, shkallë të jashtme të pashoqëruara nga rampat, korridoret e gjerësive të papërshtatshme dhe me disnivele, ashensorë të munguar (apo jofunksionalë), apo të përmasave të papërshtatshme, të papajisura me elemente në gjuhën Braille, etj. Janë edhe shumë probleme të tjera që janë të përmbledhura në formularët e vlerësimit.

Përfundimisht, në përmbyllje të raportit krahas rekomandimeve teknike dhe shembujve të zgjidhjeve sipas praktikave të mira, rekomandohet një angazhim më i gjerë institucional, në drejtim të eliminimit të barrierave arkitektonike në hapësirat e përbashkëta të ndërtesat e banimit kolektiv. Krahas rekomandimeve praktike për përshtatjen e ndërtesave dhe pajisjen e tyre me elementet qasëse për kapërcimin e disniveleve, lehtësimin e lëvizjes, lehtësimin në orientim në ndërtesë, etj., jepen edhe udhëzime për rritjen e angazhimit institucional të komunës së Prishtinës përmes dikastereve të veta. Andaj, rekomandohet që të gjithë drejtoritë relevante të angazhohen, që të sigurojnë që gjatë trajtimit të projekteve për dhënien e lejes ndërtimore, inspektimeve komunale të punëve ndërtimore të kësaj tipologjie ndërtimesh dhe përfundimisht, dhënies së lejeve të banueshmërisë, të zbatojnë normat projektuese për qasje sipas Udhëzimit Administrativ 33/ 2007 dhe rregulloret tjera, që kanë për qëllim krijimin e një mjedisi të ndërtuar që i shërben njësoj gjithë qytetarëve.

01 Sfondi i problemit

Përkufizimet kryesore

Aftësia e kufizuar

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, aftësia e kufizuar është pjesë të qenit njeri.² Në përkufizimin e saj themelor përfshihen dëmtimet dhe konditat shëndetësore të individit dhe situatat e krijuara nga faktorët e jashtëm personalë apo shoqërorë. OBSH në platformën e saj online thotë se mjedisi rrethues ka një kontribut të madh në shkallën e përjetimit të aftësisë së kufizuar nga një person. Paqasshmëria e mjedisit, vazhdon përkufizimi, krijon barrierë që pengojnë pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri dhe në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Sipas vlerësimeve të fundit të OBSH-së, në botë janë diku rreth 1.3 miliard njerëz (apo 16% të popullsisë botërore) me aftësi të kufizuara. Por meqë popullsia po plaket, ky numër pritet të jetë edhe më i madh.

Ekzistojnë përjasje të ndryshme se si vrojtohet aftësia e kufizuar. Në përpjekje për të dhënë përkufizim gjithpërfshirës të aftësisë së kufizuar, në fillim të viteve 2000, duke u bazuar edhe në modelin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar, OBSH e hartoi kornizën matëse të aftësisë së kufizuar dhe shëndetit, duke sintetizuar, ndër të tjera, modelet mjekësore dhe sociale të aftësisë së kufizuar në kornizën e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksioneve (ICF).³ Kjo kornizë ofron një përjasje relative dhe perspektivë të gjerë të klasifikimit të funksioneve, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit. Duke qenë se aftësia e kufizuar dhe problemet funksionale të njeriu janë të lidhura me kontekstin, në këtë kornizë është integruar edhe një listë e faktorëve mjedisorë.⁴

² Faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, https://www.who.int/health-topics/disability#tab=tab_1, (qasur më, 05.12.2022)

³ Basha R., Hapësira publike për të gjithë, konceptet e përgjithshme, Qendra Multimedia, 2021

⁴ OBSH, <http://www.who.int/classifications/icf/en/>, (qasur më 05.12.2022)

Qasshmëria/ Arritshmëria

Nocioni qasje ngërthen në vete mundësinë e arritjes, hyrjes dhe shfrytëzimit të një hapësire/ objekti, mundësinë e komunikimit dhe marrjes së informatave, mundësinë e lëvizjes/ mobilitetit (Basha R, 2019, 2021).⁵ Në raportin *Si të projektohet dhe promovohet një mjedis i qasshëm për të gjithë?*, Handicap International (2009),⁶ mjedisin fizik të qasshëm e përkufizojnë si mjedisin që lejon lëvizje të lirë dhe shfrytëzim të sigurt për të gjithë, pa dallim moshe, aftësie, gjinie, etj.

Barrierë arkitektonike

Barrierë arkitektonike është cilado pengesë fizike që kufizon lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjedisit të ndërtuar nga ana e personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, fëmijëve të vegjël, prindërve me foshnja, etj. Barrierat arkitektonike janë të ndërlidhura ngushtë me barrierat institucionale dhe kulturore. Barrierat institucionale janë pengesat administrative, mungesa e mekanizmave ligjorë, që e pamundësojnë eliminimin e barrierave arkitektonike. Barrierat kulturore janë qendrimet kulturore, paragjykimet dhe mendësia (e qytetarëve, administratorëve, zyrtarëve, arkitektëve) karshi aftësisë së kufizuar, që i mbajnë gjallë barrierat arkitektonike.

Modelet e aftësisë së kufizuar dhe mjedisi i ndërtuar

Aftësia e kufizuar përgjatë viteve është vërtetuar nga perspektiva të ndryshme, të cilat, ndër të tjera kanë ndikuar në konceptimin e zgjidhjeve në mjedisin e ndërtuar për akomodimin e aftësisë së kufizuar. Më poshtë janë listuar disa nga këto modele të aftësisë së kufizuar dhe kontributi i tyre në mjedisin e ndërtuar (sipas Jackson M. A. , 2018 dhe Basha R., 2019, 2021).

Modeli i mëshirës – është një nga modelet më të hershme. Bazohet në imazhin e mëshirës, varësisë, turp-it dhe dhembshurisë. Personat me aftësi të kufizuara zakonisht i kanë izoluar dhe segreguar me qëllim të mbrojtjes dhe kujdesit, por edhe mbrojtjes së rendit shoqëror dhe ekonomik nga ta. Për ta realizuar izolimin dhe kujdesin, institucionet fetare në të shumtën e rasteve kanë ndërtuar komplekset e azileve për persona me aftësi të kufizuara fizike dhe mentale, larg qendrave urbane.

⁵ Basha R., Hapësira publike për të gjithë, rasti i Prishtinës dhe Prizrenit, tezë doktore (2019), <https://upt.al/arti-kuj-shkencore/1097-fau-hapesira-publike-per-te-gjithe-rasti-i-prishtines-dhe-i-prizrenit> (qasur më, 05.12.2022)

⁶ How to Design and Promote an environment accessible to all, Policy Paper, Handicap International, 2009, http://www.hiproweb.org/uploads/tx_hidrtdocs/AccessibilityBD_01.pdf, të Basha R., Hapësira Publike për të gjithë, Rasti i Prishtinës dhe Prizrenit, tezë doktore, Universiteti Politeknik Tiranë, 2019

Modeli mjekësor – e trajtonte aftësinë e kufizuar si sëmundje, gjendje e përhershme të një numri të vogël të njerëzve që kanë nevojë për trajtim mjekësor. Ngjashëm si te modeli paraprak, nuk konsiderohej e nevojshme përshtatja e mjedisit të ndërtuar, por me raste jepeshin zgjidhje të specializuara për probleme të caktuara shëndetësore. Promovohej ndërtimi i institucioneve strehuese të aftësisë së kufizuar jashtë qendrave urbane.

Modeli social – është modeli i parë që bën kthesën në mendësinë e përgjithshme se si duhet trajtuar aftësia e kufizuar në vitet 1970-ta. Aftësia e kufizuar nuk konsiderohet patologji e brendshme e individit, por trajtohet si problematikë që rrjedh prej faktorëve të jashtëm, mjedisit shoqëror dhe fizik. Aftësia e kufizuar nuk është gjendje e qenësishme e individit, por situatë e krijuar për të. Është modeli që e inauguron termin aftësi e kufizuar. Sipas autores Clara Greed, arkitektët janë ndër agjentët kryesorë të kufizimit të lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara – të krijimit të barrierave arkitektonike në mjedisin e ndërtuar.⁷ Kontributi i modelit social është frymëzimi i fushatave për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe komunikative në mjedis në shoqëri.

Modeli i diversiteteve – ky model avokon që arkitektët të largohen nga praktika e përdorimit të përmasave normative mesatare të trupit të njeriut për dimensionimin e hapësirës, por që të zgjerojnë ‘kallëpin’ duke u bazuar në diversitetin shoqëror, politik dhe kulturor që përfaqësohen nga aftësia e kufizuar.

Modeli i të drejtave të njeriut – shërbeu për t’i dhanë shkas dokumentit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2006. Modeli i bazuar në të drejtat e njeriut arriti që me sukses ta problematizonte mjedisin e ndërtuar të paqasshëm dhe të ndikonte në ndërtimin e legjislacioneve kombëtare për eliminimin e barrierave arkitektonike në mjedisin e ndërtuar, duke u bazuar në të drejtat universale të gjithë qytetarëve.

Dokumentet kryesore udhëzuese

Eliminimi i barrierave arkitektonike për të mundësuar qasjen në mjedisin e ndërtuar për personat me aftësi të kufizuara parasëgjithash është çështje e të drejtave të njeriut. Korniza ligjore është instrumenti që ndërton dhe mbështet argumentet më bindëse për të mundësuar qasje të barabartë në mjedisin e ndërtuar dhe integrimin e personave të marginalizuar në shoqëri. Një nga detyrat kryesore të kornizës ligjore është edhe lufta kundër diskriminimit në shoqëri

⁷ Greed Clara, *Inclusive Urban Design: Public Toilets*, Routledge, 2003

(Basha R, 2019, 2021). Është një numër i dokumenteve dhe mekanizmave ligjorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që krijojnë bazën mbi të cilat ngrihen parimet për mundësimin e të drejtave të barabarta personave me aftësi të kufizuara përmes eliminimit të barrierave nga mjedisi i ndërtuar.

Dokumentet kryesore ndërkombëtare

Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut (1948)⁸ – të gjitha shtetet nënshkruese të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut kanë për obligim që përmes kornizës së vet ligjore të garantojnë dhe veprojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut, si dhe të luftojnë diskriminimin e çfarëdo ngjyre.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006)⁹ – në preambulën e saj thekson se “qasja në mjedisin fizik, shoqëror, ekonomik, kulturor, arsim, shëndetësi, informatë dhe komunikim, është aspekt që ua garanton personave me aftësi të kufizuara të gjitha të drejtat dhe liritë themelore njerëzore”. Sipas këtij dokumenti, shtetet palë kanë për obligim që të identifikojnë dhe eliminojnë të gjitha barrierat që pengojnë qasjen, përfshirë edhe barrierat në banim¹⁰ (neni 9, paragrafi 1.a). Në po këtë nen, si dhe në komentin e përgjithshëm nr. 2, specifikohet zbatimi i dizajnit universal në të gjitha mallrat, produktet, objektet, teknologjitë dhe shërbimet, që të sigurohet qasje e plotë, e barabartë dhe e pakufizuar për të gjithë potencialin e konsumatorëve.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) (2013)¹¹ – janë gjithsej 7 targete të OZHQ-ve që trajtojnë çështjet e aftësisë së kufizuar. Objektivi i 11-të thotë: “Qytetet dhe vendbanimet e njerëzve të bëhen gjithëpërfshirëse, të sigurta, të rimëkëmbshme dhe të qëndrueshme”.

Konferenca UN Habitat III dhe Agjenda e Re Urbane 2030 (NUA) (2016) – Në paragrafin 32 të këtij dokumenti parashtrohet përkushtimi për të promovuar politikat kombëtare, lokale dhe sublokale të banimit, që mbështesin realizimin progresiv të së drejtës për banim për të gjithë (...). Ndërsa në paragrafin 34 parashtrohet përkushtimi për të promovuar qasjen e barabartë dhe të përballueshme në infrastrukturën bazike fizike dhe sociale për të gjithë, pa diskriminim, ndër të tjera edhe në banim. Dhe në vazhdim të këtij paragrafi parashtrohet përkushtimi për sigurimin e shërbimeve që i përgjigjen (ndër të tjera) të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara (...). Dhe se në këtë drejtim, inkurajojnë eliminimin e barrierave ligjore, institucionale, socioekonomike dhe fizike.¹²

⁸ E miratuar në Asemblenë Gjenerale të Kombeve të Bashkuara në vitin 1948 në Paris. Burim: Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut – (ang.) Office of the High Commissioner for Human Rights, <http://www.ohchr.org/en/issues/pages/whatarehumanrights.aspx>

⁹ Konventa e Kombeve të Bashkuar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, <https://www.un.org/development/desa/disabilities/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html> (qasur më, 05.12.2022)

¹⁰ Ibid. (qasur më 05.12.2022)

¹¹ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), <https://sdgs.un.org>, (qasur më, 05.12.2022)

¹² Agjenda e Re Urbane 2030, The New Urban Agenda: Key Commitments – United Nations Sustainable Development (qasur më, 05.12.2022)

Ligjshmëria dhe dokumente kombëtare

Është një numër i ligjeve të Republikës së Kosovës përmes së cilave garantohen dhe mbrohen të drejtat elementare të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Republika e Kosovës angazhohet vazhdimisht drejt përfshirjes së Konventave Ndërkombëtare në kuadrin ligjor. Synimi për integrimet evropiane, bëjnë që Republika e Kosovës, njësoj si shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor të punojnë drejt përmbushjes së kërkesave bazuar në politikat e zgjerimit të Bashkimit Evropian, duke e harmonizuar gjithë legjislacionin me atë të Bashkimit Evropian. Sipas Coleman dhe Lebbon, sot Bashkimi Evropian e ka të rrënjosur në mendësinë e vet shoqërore qëndrimin se personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit nuk janë njerëz ndryshe, por janë pjesë e kontinuumit qytetar evropian, integrimi më i plotë në shoqëri i të cilëve duhet të bëhet përmes dizajnit më të mirë të mjedisit, produkteve dhe shërbimeve¹³ (Coleman dhe Lebbon, 2003 te Basha R., 2019). Andaj, harmonizimi i ligjeve kombëtare me ato të BE-së jep shpresë për emancipimin shoqëror dhe krijimin e një fryme më tolerante shoqërore.

Termat aftësi e kufizuar dhe persona me aftësi të kufizuara i gjejmë të përkufizuar në disa ligje. Ky përkufizim, që është i ngjashëm me atë në KKBDPAK¹⁴ thotë se personat me aftësi të kufizuara janë "personat që kanë dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund t'ua vështirësojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët."

Ligjet që ndërlidhen me problematikën e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu rregulloret, udhëzimet administrative dhe vendimet në nivel vendi janë të shumta. Sipas studimit të OJQ Handikos të fundit të vitit 2016,¹⁵ çështjet që i prekin drejtpërdrejtë apo tërthorazi personat me aftësi të kufizuara, krahas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shpalosen në gjithsej 27 ligje, 6 rregullore, 22 Udhëzime Administrative dhe 3 vendime qeveritare. Udhëzimet administrative janë të hartuara në dikasterët e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Ndërsa, bazuar në publikimin e EC Ma Ndryshe "Prizreni, qytet që nuk i ka mënjeluar barrierat për PAK" (2016), duke u bazuar në klasifikimin e bërë nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në Kryeministrinë e Republikës së Kosovës, ligjet që i dedikohen Personave me Aftësi të Kufizuara grupohen në ligjet specifike për persona me aftësi të kufizuara, ligje që kanë disa provizione të rëndësishme për persona me aftësi të kufizuara dhe 3 akte legjislative të rëndësishme për

¹³ Coleman R., Lebbon C., Introduction from Margin to Mainstream, në Clarkson, Coleman R., Keates S., Lebbon C. (Eds.), *Inclusive Design: Design for the Whole Population*, Springer-Verlag Ltd., London, 2003

¹⁴ Minci F., Prizreni, Qytet që nuk i kanë mënjeluar barrierat për PAK, publikim online nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK, ATRC dhe USAID, fq. 9, <http://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2018/09/Prizreni-qytet-qe-nuk-i-ka-menjanuar-barrierat.pdf>, (qasur më, 24.01.2019)

¹⁵ OJQ HANDIKOS (edituar nga Osman Shatri), Përmbledhje e legjislacionit mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, http://handi-kos.org/repository/docs/PERMLEDHJE_LEGJISLACION-I_MBI_TE_DREJTA_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE_KUFIZUARA_628624.pdf, (qasur më, 24.01.2019)

persona me aftësi të kufizuara.

Në fakt janë të shumta ligjet, që e përfshijnë çështjen e integritetit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, por ato që specifikojnë nevojën e eliminimit të barrierave arkitektonike janë fare pak. Bazuar në raportin hulumtues të marsit të vitit 2020 'Standardet ndërkombëtare mbi çështjet e aftësisë së kufizuar – Ku qëndron Kosova?'¹⁶, vlerësohet se 'më pak se një e treta (30.72%) e detyrimeve (standardeve) të vlerësuara ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar (KKBDPAK, EU Acqui, SDG) janë të përfshira plotësisht në legjislacionin e Kosovës. (...) Qasja mbetet kategoria më sfiduese, me vetëm 6.77% të standardeve të përfshira plotësisht në legjislacion.' Prej vitit 2020 situata në këtë drejtim nuk ka ndryshuar fare, andaj mund të thuhet se standardet e qasjes mbeten njësoj edhe 2 vite pas përmbylljes së atij hulumtimi.

Disa nga ligjet që përfshijnë çështjet e personave me aftësi të kufizuara dhe krijojnë bazën për eliminimin e të gjitha barrierave (përfshirë edhe arkitektonike) janë të listuara më poshtë:

Ligji nr. 05/L –021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹⁷ – Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është ligj që ndërlidhet me disa Direktiva të Këshillit të Evropës që mbrojnë të drejtat e njeriut. Ky ligj është një instrument i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit të çfarëdo ngjyre (neni 1, pika 1). Shkeljet që i trajton ky ligj, ndër të tjera, sipas këtij neni, janë edhe qasja në punësim, arsim dhe shëndetësi. Pengimi i realizimit në plotëni i të drejtave dhe lirive të njeriut përmes moslejimit të qasjes në vendbanim, vende publike dhe në furnizim me mallra dhe shërbime, janë problemet që rrjedhin kryesisht nga barrierat që e pengojnë qasjen/ arritshmërinë në mjedisin fizik/ të ndërtuar.

Ligji për Planifikimin Hapësinor, nr. 04/L174¹⁸ – Edhe pse e synon rregullimin e qëndrueshëm të hapësirës, me qëllim të sigurimit të trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve, lëvizje të lirë dhe qasje në shërbime publike për të gjithë qytetarët, në asnjërin nen a paragraf nuk ekziston asgjë që garanton dhe rregullon eliminimin e barrierave arkitektonike nga mjedisi i ndërtuar.

Ligji për Ndërtim, nr. 04/L-110 – Ligji aktual i ndërtimit nuk ka asnjë dispozitë specifike me të cilin rregullohen çështjet e qasjes në mjedisin e ndërtuar për persona me aftësi të kufizuara.

¹⁶ Basha R. Dhe Çeku H., Standardet ndërkombëtare mbi çështjet e aftësisë së kufizuar – Ku qëndron Kosova?, Vlerësim i legjislacionit të Kosovës në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuar në raport me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Handikos, 2020, http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/05/Report_SHQ-_29_04_20_95548.pdf

¹⁷ Ligji nr. 05/L-021, për mbrojtjen nga diskriminimi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 16/ 26.06.2015), <https://g-zk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>, (qasur më, 18.01.2019)

¹⁸ MMPH, Ligji për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L174, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 30/2013)

Udhëzimi administrativ i MMPH-së nr. 06/2017 – Për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për Kategorinë I dhe II të Ndërtimeve – Procedurat e shqyrtimit të kërkesës për lëshimin e lejes ndërtimore përshkruhen në nenin 17. Për objektet që sipas legjislacionit të ndërtimit klasifikohen te kategoria II, ndër të tjera, kërkohet që ato duhet të jenë të qasshme/arritshme për persona me aftësi të kufizuara, për ndërtimet në të cilat kërkohet një qasje e tillë sipas ligjit në fuqi (neni 17, pika 2.2.6.). Objektet ndërtimore të kategorisë II, sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH-së, nr. 04/2017 për kategorizimin e ndërtimeve, në klasifikimin e tyre përfshijnë edhe ndërtesat e banimit dhe banimit të përbashkët (shtëpitë për të moshuar, konviktet, internatet, kopshtet për fëmijë) dhe hotelieria.

Shtojca nr. 3 e këtij Udhëzimi Administrativ, i cili titullohet “Dokumentet e nevojshme për aplikacionet për leje ndërtimore”, përmban formularin që liston llojin e dokumenteve të nevojshme dhe njëkohësisht shërben për verifikimin e plotësimit të kushteve nga aplikacionet për leje ndërtimi. Seksioni numër VIII i kësaj liste titullohet “Qasja e njerëzve me aftësi të kufizuara (vetëm për kategorinë II dhe III)”. Këtu listohen dokumentet e domosdoshme që duhet të plotësohen, si: Specifikacionet teknike; Parametat dhe udhëzimet teknike për realizimin e punëve ndërtimore, etj.

Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuar nr. 33/2007 – jep përmasat themelore të elementeve qasëse për kapërcimin e disniveleve të hyrjet në ndërtesa, si dhe përmasat, pajisjet dhe mënyrën e projektimit të hapësirave të ndryshme në ndërtesa, që të jenë të përshtatshme për shfrytëzim nga personat me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore. Në nenin 5, në listën e ndërtesave dhe hapësirave të cilat mund të përshtaten sipas këtij udhëzuesi janë edhe ndërtesat e banimit, ndërtesat afaristo – banesore, vendbanimet për studentë, për të moshuar, etj.

Udhëzimi administrativ në nene të veçanta jep rregullat për elementet qasëse që mundësojnë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore, psh. dimensionimet e parkingjeve për PAK, rampat qasëse, ashensorët, platformat ngritëse vertikale, fushat taktore, etj. Këtu përfshihen edhe nenet që rregullojnë hapësirat e caktuara brenda ndërtesave të banimit, komunikatat, hyrjet, shkallët, etj. Të gjithë parametrat teknikë dhe elementet qasëse për ndërtesa dhe sipërfaqe publike, në dokument ilustrohen me skica të dimensionuara. Në fund, jepet përmbajtja e domosdoshme e projektit arkitektonik për ndërtimin dhe rindërtimin e ndërtesave arkitektonike dhe infrastrukturore, bashkë me fazat projektuese, të nevojshme për aplikim për leje ndërtimi.

Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013–2023 – është “mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar që parimet të cilat janë të mishëruara në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (të) jenë të inkorporuar në politikat dhe programet që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetesës së Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës”.

Plani i Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2018–2020 për Komunën e Prishtinës – ndër të tjera ia adreson kërkesën për adaptimin e trotuareve për lëvizje të përdoruesëve të karrocave Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Kapitale. Kësaj drejtorie i kërkohet edhe adaptimi i ndërtesave publike, për të qenë të qasshme për përdorues karrocash. Këtu kërkohet që për bazë të merret raporti i vitit 2016, i prodhuar nga OJQ HANDIKOS dhe financiar nga GIZ, i cili shpalos shkallën e ndërtesave të paqasshme për persona me aftësi të kufizuara në ndërtesa publike në komunën e Prishtinës.¹⁹

Sipas këtij dokumenti përgjegjësia për adaptimin dhe krijimin e hapësirave për aktivitete ditore për persona me aftësi të kufizuara, si dhe adaptimin e të gjitha ndërtesave për persona me aftësi të kufizuara, i takojnë Drejtorisë së Urbanizmit.

Rregullore MMPH 03/2016, Për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi – përmbledh disa nene që japin normat teknike për disa elemente qasëse në rrethinën dhe në brendi të ndërtesës shumëbanesore. Neni 17, paragrafi 3, tregon përshtatjen e hyrjes për qasje të personave me aftësi të kufizuara. Neni 18, paragrafi 5, jep parametrat për përshtatjen e hyrjes (erëmbrojtësit). Neni 19, paragrafi 7 jep lartësitë e ndërprerësive dhe zileve në komunikatat e përbashkëta. Ndërsa paragrafi 8 i këtij neni thotë që të gjitha sipërfaqet për komunikimin horizontal duhet të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Neni 20, paragrafi 3, thotë se të gjitha komunikatat vertikale duhet t'i plotësojnë kushtet për personat me aftësi të kufizuara. Neni 21, paragrafi 7, të gjithë ashensorët duhet të projektohen sipas parametrave që të jenë të qasshëm për persona me aftësi të kufizuara. Neni 27, paragrafi 7, cakton parametrin e numrit të parkingjeve për persona me aftësi të kufizuara kundrejt numrit të përgjithshëm të parkingjeve të ndërtesës.

¹⁹ Basha R., Raporti i hulumtimit mbi barrierat arkitektonike në ndërtesat publike “Prishtina për të gjithë”, nëntor 2016, Handikos dhe GIZ

Problematika e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në ndërtesat shumëbanesore të Prishtinës

Në Republikën e Kosovës prej më shumë se 15 vjetësh ekziston një dokument – udhëzues që rregullon eliminimin e barrierave nga mjedisi i ndërtuar. Por përkundër këtij fakti, mjedisi i ndërtuar në qytetet e Kosovës vazhdon të jetë i paqasshëm. Organizatat e aftësisë së kufizuar dhe ato të shoqërisë civile, prej më shumë se 2 dekadash, avokojnë për luftimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë kosovare. Një formë e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë kosovare janë edhe ndërtesat dhe hapësirat publike me barriera arkitektonike, që pengojnë lëvizjen e lirë, autonominë dhe jetesën e pavarur.

Ekzistojnë një numër raportesh që dëshmojnë nivelin e paqasshmërisë së mjedisit të ndërtuar në qytetet më të mëdha kosovare, që tashmë janë hartuar si pjesë e hulumtimeve dhe auditimeve të ndërtesave dhe hapësirave publike. Hulumtimet e kryera, në numër më të madh janë për qytetin e Prishtinës. Por kemi edhe raporte që shpalosin problematikën e qasshmërisë në sektorë të veçantë, si p.sh. arsimin apo shëndetësinë.

Është evidente tashmë se cilat janë pasojat e hapësirave dhe sipërfaqeve publike të paqasshme në jetën e një personi me aftësi të kufizuara. Përderisa ekzistojnë pengesat në trotuare, në hyrje të shkollave, administratës, qendrave të mjekësisë familjare apo ndërtesave të tjera publike, personat me aftësi të kufizuara mbesin të përjashtuar nga sistemi arsimor, nga sistemet e aftësimi profesional dhe me këtë edhe nga puna dhe aspektet tjera të jetës shoqërore. Për më shumë, në pamundësi që të përfshihen në tregun e punës, personat me aftësi të kufizuara, janë grupi më i prekur nga varfëria dhe me këtë mbeten komunitet i varur, qoftë nga familjet dhe të afërmit e tyre ashtu edhe në skemat ndihmëse të shtetit. Nëse 'Çrrënjësja e varfërisë në nivel global' është objektivi i parë i synuar i Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030, atëherë një nga motivet për arritjen e këtij objektivi është edhe krijimi i kushteve që, përmes eliminimit të barrierave arkitektonike në mjedis të ndërtuar, t'iu mundësohet shkollimi, punësimi dhe pavarësia ekonomike dhe autonomia komunitetit të personave me aftësi të kufizuara.

Kërkesa për mjedise të ndërtuara të qasshme është edhe kërkesë legjitime për një jetë të dinjitetshme, që të mund të gëzojnë të mirat e qytetit jo në barrën e mëshirës së tjetërkujt, por me të drejtat të barabarta me gjithë qytetarët e tjerë.

Siç u tha më lart, vlerësimi i qasjes së ndërtesave publike dhe i sipërfaqeve publike në Prishtinë është kryer disa herë, edhe pse përtej evidentimit të barrierave arkitektonike, nuk është ndërmarrë ndonjë veprim serioz për eliminimin sistematik të tyre. Intervenimet e pakta përmirësuese në mjedisin e ndërtuar me qëllim të eliminimit të barrierave që pengojnë qasjen e personave me aftësi të kufizuara, shpeshherë, u ngjasojnë adaptimeve të këqija që e përforcojnë problemin e mungesës së gjithëpërfshirjes në këto ndërtesa. Këto adaptime, në të shumtën e rasteve janë pasojë e zbatimit sipërfaqësor të kërkesave nga legjislacioni, pa studim të kontekstit, të ngjyrosura me paragjykime nga arkitekti, zbatuesi i punëve dhe zyrtari komunal (Basha R, 2019, 2021).

Deri më tani, në qytetet kosovare nuk ka pasur ndonjë përpjekje serioze për evidentimin e barrierave arkitektonike në ndërtesa të banimit. Ndërtimet e banimit shumëbanesor, sot kryesisht janë struktura të ndërtuara nga investimet private dhe në qytetet si Prishtina, akomodojnë pjesën më të madhe të qytetarëve. Organizatat e personave me aftësi të kufizuara janë përpjekur të merren me vlerësimin e qasjes së disa ndërtesave ku banojnë anëtarësia e këtyre organizatave. Këto vlerësime kryesisht kanë synuar mbledhjen e të dhënave të izoluar, për ndonjë intervenim eventual përmirësues, të sponsorizuar në të shumtën e rasteve nga financimet e familjarëve të personave me aftësi të kufizuara, nga donatorë të organizatave, dhe tek-tuk ndonjë përshtatje e hyrjes apo rampës nga fondet komunale.

Stoku i ndërtesave të banimit shumëbanesor në Prishtinë përbëhet nga ndërtesat e ndërtuara në periudhën e pasluftës së dytë botërore deri në vitet '90 të shekullit XX dhe nga ndërtesat e ndërtuara pas luftës së viteve '98-'99. Secila periudhë i ka karakteristikat e veta pronësore dhe teknologjike. Ato që janë ndërtuar para vitit 1999, kanë qenë investime publike, të planifikuara me shumë kujdes, në të cilat banorët kanë qenë shfrytëzues kundrejt qirasë që i është paguar ndërmarrjes shtetërore (deri në mes të viteve 1990, kur fillojnë privatizimet). Ndërtesat e banimit kolektiv pas vitit 1999, janë investime private (në masë të madhe të bazuar në remitencat e diasporës), që në vitet e para janë ndërtuar në mënyrë stihike në një treg kaotik ndërtimesh, me parregullësi të shumta, mosrespektim rregullativash urbane dhe me probleme të shumta teknike. Për më shumë, sot shtrirja e aktivitetit ndërtimor i ndërtesave banesore, është kontribuesi më i madh i ndotjes së mjedisit dhe veprimtaria që gërryen dhe zhduk edhe ato pak elemente peizazhore të mbetura të Prishtinës. Hovi i ndërtimit të ndërtesave shumëbanesore nuk resht, përkundra të dhënat demografike dhe shkalla e migrimit dëshmojnë se Prishtina nuk ka nevojë për kaq shumë ndërtesa të reja të banimit.

Pavarësisht numrit të madh të këtyre ndërtimeve, Prishtina ka qytetarë që jetojnë në kushte të pavolitshme, meqë nuk mund të përballojnë çmimin e tregut të

banimit. Komuna (sikundër komunat tjera) përpiket ta zgjidhë këtë problem përmes skemave të programeve të veçanta të banimit. Këto struktura nuk janë në numër të madh andaj edhe nuk zgjidhin problemin e strehimit të numrit të madh të qytetarëve në nevojë. Sipas kornizës ligjore që mbledh ligjin për banimin social dhe udhëzimet administrative relevante²⁰, një nga kriteret për dhënien në shfrytëzim të një banese në këto struktura është edhe shkalla e invaliditetit. Andaj, në kuadër të këtij hulumtimi të shkurtër është vlerësuar qasshmëria për persona me aftësi të kufizuara fizike një nga këto ndërtesa.

Ndërtesat e banimit të përkohshëm për studentë duhet të jenë të hapura për të akomoduar të gjithë studentët pa dallim. Në Prishtinë rreth 4000 studentë të Universitetit të Prishtinës çdo vit akomodohen në kompleksin e konvikteve që menaxhohet nga Ministria e Arsimit dhe që gjendet ndërmjet lagjeve Ulpiana dhe Kodra e Diellit. Ky kompleks, konviktet e para i ka të ndërtuara nga fundi i viteve 1960-ta. Pas viteve 2000, kësaj qendre i janë shtuar edhe disa ndërtesa dhe hapësira të reja. I gjithë kompleksi cilësohet me shkallë të lartë të paqasshmërisë, për shkak të topografisë dhe sipërfaqeve të hapura komunikuese që nuk janë projektuar që të akomodojnë lëvizjen e studentëve me aftësi të kufizuara. Prandaj, në kuadër të këtij hulumtimi është bërë vlerësimi qasshmërisë në disa konvikteve.

Se të gjitha format e banimit duhet të jenë të qasshme për të gjithë, e thotë edhe Udhëzuesi i OBSH-së për Banimin dhe Shëndetin.²¹ Sipas këtij dokumenti, kushtet e përmirësuara të banimit mund të shpëtojnë jetë, të parandalojnë sëmundje, rritin cilësinë e jetës, ulin shkallën e varfërisë, dhe kontribuojnë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm. Ky dokument thotë edhe që kushtet e këqija të qasshmërisë në ndërtesa banimi i rrezikojnë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit nga lëndimet, stresi dhe izolimi. Nga hulumtimet e përmbledhura nga mbarë bota në Udhëzuesin e OBSH-së për Banimin dhe Shëndetin theksohet se banimi i qasshëm ndikon pozitivisht në rritjen e cilësisë së jetës, parandalimin e lëndimeve, mortalitetit, efektet psikologjike, rritjen e pjesëmarrjes në shoqëri dhe autonomi. Një nga rekomandimet e këtij dokumenti lidhet me një praktikë të mirë nga Zelanda e Re, sipas të cilës, ndërtesat që ndërtohen duke i plotësuar kushtet për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, janë 22% më efikase në aspektin e kostos së ndërtimit. Andaj, ky dokument sugjeron që rregulloret për ndërtim të qasshëm të jenë pjesë e standardeve të ndërtimit në secilin shtet, në mënyrë që ndërtimet e reja të ndërtohen duke i respektuar ato. Rekomandimi i këtij dokumenti është që standardet e qasshmërisë së ndërtesave të bazohen në standardin e Organizatës Ndërkombëtare të Standardeve (ISO), ISO 21542:2011 Building construction – Accessibility and usability of the built environment“.

²⁰ Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit nr. 03/L-164 dhe aktet nënligjore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670> (qasur më, 05.12.2022)

²¹ WHO Housing and Health Guidelines (2018), <https://apps.who.int/iris/handle/10665/276001>, (qasur më, 05.12.2022)

Metodologjia e hulumtimit

Ky studim bën vlerësimin e qasjes për persona me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore të hapësirave të përbashkëta të një përzgjedhjeje të ndërtesave shumë-banesore, të banimit social, konvikteve të studentëve në kompleksin e Qendrës Studentore, në qytetin e Prishtinës.

Vlerësimi i hapësirave të përbashkëta jashtë dhe brenda ndërtesave bëhet me anë të Udhëzimit Administrativ 33/ 2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili është i vetmi dokument normativ që jep standardet për eliminimin e barrierave që pengojnë qasshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, të të gjitha tipologjitë e ndërtimeve, ku një qasje e tillë kërkohet. Udhëzimi Administrativ 33/2007, është akt nënligjor që rrjedh nga Ligji i Ndërtimit (tashmë i shfuqizuar) 2004/15.

Pjesa thelbësore e këtij studimi është vizita e ndërtesave dhe evidentimi i barrierave arkitektonike kundrejt listës kontrolluese që përfshinte hapësirat e përbashkëta në afërsinë imediate të ndërtesës dhe ato në brendi të saj. Krahas U.A. 33/2007, për vlerësimin e qasshmërisë së këtyre ndërtesave janë marrë parasysh edhe disa praktika të mira nga dokumente ndërkombëtare dhe rishikimi i literaturës së viteve të fundit.

Ky aktivitet i vlerësimit të qasshmërisë së ndërtesave shumëbanesore është përqendruar kryesisht në barrierat që pengojnë personat me aftësi të kufizuara fizike (në veçanti përdoruesit e karrocave mekanike dhe elektrike) dhe personat e verbër si dhe ata me shikim të dëmtuar. Kjo përzgjedhje është bërë për shkak se këto grupe të aftësisë së kufizuar e kanë më të ndërlikuar përballjen me mjedisin fizik, në veçanti kapërcimin e disniveleve, shfrytëzimin e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të ndërtesave dhe orientimin në to. Problemet e ngjashme, përkohësisht, mund të kenë edhe personat e lënduar, të sëmurë, të moshuarit, personat që kujdesen për të sëmurët apo foshnjat.

Fokus i këtij aktiviteti hulumtues në terren ishte të kuptohet se sa janë në përputhshmëri hapësirat e përbashkëta të jashtme dhe të brendshme me normat e dhëna në U.A. 33/2007, si dhe të jepen rekomandimet për përmirësimin e problemeve më akute të hasura gjatë hulumtimit.

Janë vlerësuar gjithsej 28 ndërtesa të gjitha lagjet e mëdha të Prishtinës. Përpos ndërtesave të banimit kolektiv, në hulumtim është përfshirë edhe një ndërtesë e banimit social dhe 2 konvikte.

Për të vlerësuar këto ndërtesa banimit, fillimisht janë marrë për bazë ndërtesa, në të cilat banorë janë persona me aftësi të kufizuara fizike. Janë siguruar gjithsej 11 adresa nga organizatat e aftësisë së kufizuar, prej të cilave janë vlerësuar 7.

I zbërthyer, instrumenti i vlerësimit ka përmbajtjen si vijon:

- Informata të përgjithshme – në të cilat përmbledhen të dhënat e lokacionit, tipologjisë, etj.
- Hyrja në ndërtesë ose hapësira përreth ndërtesës – që përmbledh elementet arkitektonike që e mundësojnë qasjen deri te hyrja në ndërtesë: parkingu për persona me aftësi të kufizuara, qasja deri te hyrja, rampat (pjerrinat), shkallët e jashtme, fushat/ sipërfaqet taktore udhëzuese dhe ato paralajmëruese që çojnë deri te hyrja(et) kryesore në ndërtesë, shenjat e qasjes, planin e orientimit, etj.
- Hapësira e brendshme e ndërtesës – përmbledh qasjen në brendi dhe mundësinë e lëvizjes horizontale dhe vertikale ndërmjet kateve të ndërtesës. Këtu janë këqyrur shkallët e brendshme, rampat, përmasat e hapësirave komunikuese. Një aspekt shumë i rëndësishëm që vlerësohet është edhe ekzistimi i fushave taktore për lëvizje horizontale në ndërtesë, si dhe vijat kontrastuese në shkallë dhe denivelime, ashensori dhe përmasat e tij, shenjat e qasjes, etj.

Ekipi i hulumtuesve në terren përbëhej nga 2 hulumtues, studentë të vitit të pestë (nivelit master) të Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina. Për të plotësuar formularin, hulumtuesit duhet të vizitonin ndërtesën në eksterier dhe në enterier (aty ku iu është lejuar). Përpos këtij vëzhgimi, puna përfshinte edhe verifikimin përmes matjeve të përmasave të disa hapësirave apo elementeve të komunikimit vertikal dhe horizontal. Këto përmasa janë të nevojshme për të vlerësuar nëse hapësirat e caktuara apo elementet komunikuese janë të përshtatshme për shfrytëzim nga personat me aftësi të kufizuara. Disa pjesë dhe elemente problematike në ndërtesat e vëzhguara janë evidentuar edhe përmes fotografimit.


Duhet theksuar se sa i përket shqyrtimit të mjedisit përreth ndërtesës është marrë parasysh vetëm hapësira e menjëhershme që është pjesë e pronës së ndërtesës, apo pjesë e sipërfaqes publike pranë ndërtesës. Sipërfaqja dhe

hapësira publike, si dhe elementet përbërëse të saj, infrastruktura rrugore dhe transporti urban nuk janë trajtuar fare në këtë vlerësim.

Lagjet e Prishtinës ku janë vlerësuar ndërtesat:

NR.	LAGJJA E PRISHTINËS	TIPOLOGJIA	PERIUDHA E NDËRTIMIT
1	Dardania	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
2	Dardania	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
3	Ulpiana	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
4	Ulpiana	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
5	Ulpiana	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
6	Ulpiana	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
7	Kodra e Diellit	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
8	Kodra e Diellit	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
9	Kodra e Diellit	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
10	Kodra e Diellit	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
11	Lakrishtë	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
12	Qendër	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
13	Qendër	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
14	Qendër	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
14	Taukbashçe/Tashlixhe	Ndërtesë shumëbanesore	Para vitit 1999
15	Emshir/Kalabri	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
16	Emshir/Kalabri	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
17	Arbëri	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
18	Arbëri	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
19	Tophane	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
20	Dodona	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
21	Prishtina e Re	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
22	Velani	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
23	Lagjja e Spitalit	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
24	Mati 1	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
25	Mati	Ndërtesë shumëbanesore	Pas vitit 1999
26	Qendra e Studentëve	Konvikt studentësh	Para vitit 1999
27	Qendra e Studentëve	Konvikt studentësh	Pas vitit 1999
28	Hajvali	Banim social	Pas vitit 1999

Shtirirja hapësinore në qytetin e Prishtinës e ndërtesave shumëbanesore të vlerësuara.




Vlerësimi i parametrave themelorë të qasjes

Elementet themelore qasëse në ndërtesa banimi


Parkingu për persona me aftësi të kufizuara

Nga numri i përgjithshëm i ndërtesave shumëbanesore të vlerësuara vetëm 2 ndërtesa banimi të ndërtuara pas vitit 1999 janë të pajisura me parking për persona me aftësi të kufizuara.



Rampa

Nga 28 ndërtesat e vlerësuara, pajisja me rampa qasëse është si vijon:






Nga 9 ndërtesat e vlerësuara, që hyrjen e kishin në nivel të terrenit, 90% e tyre arrijten deri te hyrja e kishin me shumë pengesa në shtigje (disnivele apo shkallë). Janë 2 raste kur qasja në hyrje bëhet përmes platosë së ngritur, por qasja në pllato është problematike.

Figura 1.


Rampë me pjerhtësi dhe gjatësi jashtë standardeve.

Foto. L. Krasniqi, L. Olluri

Qasja brenda ndërtesës – gjerësia e hyrjes dhe erëmbrojtësi



Gjerësia e derës hyrëse në ndërtesë së paku 110/210 cm (një krah) ose 2 x 90/210 cm (dy krahëshe)



Erëmbrojtësi min. 240 cm thellësi

Hapësira e përbashkët e jashtme e ndërtesës

Sipërfaqet e jashtme të ndërtesave që janë vlerësuar kryesisht janë përplot bariere, shtigje me disnivele dhe shkallë. Në disa raste kemi hyrjen në ndërtesë nga pllatoja e ngritur, ku në dy raste, qasja në pllato është me rampa të stërgjatura dhe me pjerrtësi shumë të madhe. Kujtojmë që pjerrtësia e rampave nuk duhet të jetë më e pjerrët se 5% dhe gjatësia e krahut të rampës duhet të ndërpritet në çdo 6 m gjatësi me pushimore 150 cm.

Siç u tha më lart, janë raste të shumta kur hyrja në ndërtesë është në nivel terreni, që vlerësohet si faktor pozitiv, por shtegu për të hyrja ka shkallë të shumta, por edhe pas hyrjes, kemi shkallë e disnivele në brendi të erëmbrojtësit.



Sa i përket lëvizjes së personave të verbër në drejtim të hyrjes në ndërtesë, si dhe trajtimit të shkallëve të jashtme të ndërtesës (aty ku ka shkallë të hyrjes apo të pllato të hyrëse), vlerësimi evidenton mungesë të plotë të fushave taktore (për orientimin e të verbërve) dhe të shenjzimeve me ngjyrë kontrastuese në shkallë (për lëvizjen e personave me shikim të dëmtuar).



Figura 2.

Shembuj të hyrjeve të paqasshme. Disnivele dhe shkallë të pllatoeve që çojnë drejt hyrjeve të ndërtesave.


Foto. L. Krasniqi, L. Olluri




Figura 3.

Shembuj të shkallëve dhe disniveleve në hyrje të ndërtesës shumëbanesore. Majtas: Ndërtim pas vitit 1999, Djathtas: Ndërtim para 1999.

Foto. L. Krasniqi, L. Olluri



Fusha faktore (udhëzuese apo paralajmëruese) përpara hyrjes, shkallëve a rampave të hyrjes në ndërtesë



Basamakët e shkallëve të hyrjes në ndërtesë me shirita me ngjyrë kontrastuese



Figura 4.

Basamakët e shkallëve të brendshme pa fusha faktore para dhe pas përfundimit të krahut të shkallëve. Mungesa e shiritave me ngjyrë kontrastuese në skajet e basamakëve.

Foto. L. Krasniqi, L. Olluri

Hapësira e brendshme e përbashkët e ndërtesës

Në rastet e shumta kur hyrja në ndërtesë është në nivel terreni, hapësira e përbashkët pas hyrjes, ka shkallë e disnivele, qoftë në brendi të erëmbrojtësit ose në korridorin që zhvillohet në brendi. Këto raste janë më të shpeshta te ndërtimet e viteve 1970 –1980, në qendër qyteti, kur për të krijuar privatësi për njësitë banesore të nivelit të parë, korridori i këtij niveli ngritej për minimum 140 cm (apo gjysëm kati) nga niveli i terrenit. Rastet e tilla të evidentuara gjatë vlerësimit janë në lagjen Ulpiana dhe Qendër. Këto ndërtesa, në të shumtën e rasteve karakterizohen edhe me gjerësi të pamjaftueshme të korridorit (gjerësia minimale e korridorit ndërmjet banesave rekomandohet të jetë 150 cm, që ndër të tjera të lejojë rrotullimin e karrocës së personave me aftësi të kufizuara).




Figura 5.

Disnivelet dhe shkallët në brendi të korridorit hyrës. Majtas: ndërtesë e ndërtuar para vitit 1999, Djathtas: Ndërtesë e banimit social, e ndërtuar pas vitit 1999.


Foto. L. Krasniqi, L. Olluri

Prania e ashensorëve është një aspekt tjetër i rëndësishëm që ndërtesa të jetë e qasshme për persona me aftësi të kufizuara fizike, shqisore, por edhe për lëvizjen e të moshuarve dhe prindërve me fëmijë të vegjël. Në ndërtesat e katshmërisë së ulët (P+4, P+5) të ndërtimit të vjetër, për shkak të normativave të vjetra projektuese mungon ashensori. Shumica e ndërtesave të vlerësuara në Ulpianë dhe disa në Kodër të Diellit nuk kanë ashensorë. Te ndërtesat e reja, në struktura me katshmëri të ngjashme paraqitet ashensori. Ashensorët për të qenë të qasshëm për persona me aftësi të kufizuara fizike (përdorues karrocash) dhe për personat e verbër dhe të shurdhër, duhet të kenë përmasat të mjaftueshme të derës dhe të kabinës (sipas U.A. 33/2007), duhet të jenë të pajisura me butona me shkrimin Braille dhe sinjalizime zanore. Në ndërtesat e vlerësuara, në një numër të tyre kemi hasur në ashensorë me informata në Braille dhe në dy raste ato ishin të pajisura me sinjalizime zanore. Ndërsa sa i përket përmasave, përderisa kemi raste kur kabina me përmasa i plotëson kushtet për qasshmëri, dyert janë të gjerësisë më të vogël.

Sa i përket pajisjeve të ndërpresëve të dritës dhe të zileve të njësive banesore, te ndërtesat e reja lartësia e tyre është sipas standardeve për qasshmëri të personave me aftësi të kufizuara (lartësia 90 cm nga shtresa finale e dyshemes), ndërsa te ndërtesat e vjetra nuk është ky rast.



Prania e disnivele të pakapërcyeshme në brendi të korridorit të përdhësës (përfshirë rastet e qasjes në banesa nga gjysmëkati)




Korridoret e brendshme të ndërtesës së banimit me gjerësi minimum 150 cm




Figura 6.

Koridoret e brendshme të gjerësisë më të vogël se 150 cm në ndërtesat e ndërtuara para vitit 1999.
Foto. L. Krasniqi, L. Olluri



Pajisja e ndërtesës me ashensorë sipas standardeve të parapara në U.A. 33/2007



Pajisja e ndërtesës me ashensorë sipas standardeve të parapara në U.A. 33/2007




Figura 7.


Tipet e ashensorëve të hasur në ndërtesat e investiguara.

Djathtas: Buton me shkrimin Braille.

Foto. L. Krasniqi, L. Olluri



Fusha taktore (udhëzuese apo paralajmëruese) përpara shkallëve të brendshme (përfshirë edhe në fillim dhe mbarim të një krah të shkallëve) dhe ashensorëve



Basamakët e shkallëve të brendshme në ndërtesë me shirita me ngjyra kontrastuese

Konkludim

Nga rezultatet e vlerësimit të kryer në hapësirat e përbashkëta të brendshme dhe të jashtme të një mostre të vogël prej 28 ndërtesash shumëbanesore, konvikte dhe ndërtesa të banimit social, janë evidente barrierat e shumta që i bëjnë këto ndërtesa të paqasshme për persona me aftësi të kufizuara fizike. Ky rezultat është shqetësues, duke qenë se prej vitit 2007 ekziston Udhëzimi Administrativ 33/ 2007 që rregullon ndërtimin për shfrytëzimin universal të ndërtesave të reja, si dhe përshtatjen e ndërtesave ekzistuese. Barrierat janë më të pranishme te ndërtesat e para viteve 1999 sesa në ato pas.

Praktika e qasjes në përdhesë përmes hyrjes në nivel terreni, pajisja me ashensorë (edhe te etazhitetet e mesme), si dhe vendosja e funksioneve afariste dhe tregtare në përdhesë, në ndërtesat e pas vitit 1999, mundëson që të mos paraqiten disnivelet e vogla të brendshme, apo shkallët që çojnë në gjysëmetazhën e korridorit të banesave. Ndërsa te ndërtesat e para vitit 1999, për ta ruajtur privatësinë e njësive banesore, korridori i nivelit të parë të banesave ngrihej minimum 140 cm nga terreni. Për këtë arsye, te këto të fundit, shpeshherë kemi shkallë në erëmbrojtës ose në zgjerimin e korridorit të hyrjes.

Ndërtesat shumëbanesore të etazhitetit deri në P+5 të ndërtuara para vitit 1999 nuk janë të pajisura me ashensorë. Ndërtesat e banimit social, që janë të ndërtuara pas vitit 1999, kanë disnivele në korridore. Këto të fundit, edhe pse si struktura, bazuar në Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, mund t'iu caktohen edhe personave me aftësi të kufizuara, në realitet përmbajnë pengesa që e vështirësojnë qasshmërinë fizike.

Orientimi dhe lëvizja e personave të verbër dhe me shikim të dëmtuar në ndërtesë është një tjetër pikë kritike në ndërtesat e banimit shumëbanesor. Sipas U.A. 33/2007, rekomandohet që ashensorët të pajisen me butonë me shkrimin Braille, por edhe me sinjalizues zanor, në mënyrë që të jenë të shfrytëzueshme nga personat e verbër. Një numër i ashensorëve të hasur gjatë investigimit në terren janë të pajisur me butona me shkrimin Braille, por iu mungojnë sinjalizimet zanore. E rëndësishë së njëjtë është edhe pajisja me fusha taktore që drejtojnë tek ashensorët dhe tek shkallët (para dhe pas përfundimit të krahut të shkallëve), si dhe pajisja e skajeve të basamakëve me shirita me ngjyrë kontrastuese, që do të ndihmonte shumë lëvizjen e personave me shikim të dëmtuar, të moshuarit apo lëvizjen në situata me ndriçim të papërshtatshëm. Në asnjë rast si jashtë ashtu edhe brenda ndërtesave nuk janë hasur këto elemente qasëse.

Konviktet e vlerësuara në Qendrën Studentore janë po ashtu të papajisura me elemente qasëse. Nuk ka as ashensorë, shkallët nuk janë të pajisura me elemente

qasëse për persona të verbër dhe me shikim të dëmtuar. Dhomat e vlerësuara nuk kanë hapësirë të mjaftueshme lëvizjeje për persona me aftësi të kufizuara, si dhe nuk ka banja apo tualete të qasshme.

Një problem tjetër kritik është edhe mungesa e parkingjeve të qasshme për PAK. Sipas Rregullores për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi si dhe Hapësirat në Funkcion të tyre, sikurse edhe në Udhëzimin Administrativ 33/ 2007, kërkohet që në çdo 20 parkingje të parashihet një parking për PAK, i cili i ka përmasat e caktuara dhe ka shenjëzim horizontal dhe vertikal.

04 Rekomandimet

Rekomandimet e përgjithshme

Ministria e Infrastrukturës dhe e Mjedisit, e cila është sponsorizuese e ligjeve që lidhen me mjedisin e ndërtuar, të formojë një grup punues të përbërë nga akterë kryesorë të fushës së ndërtimit, zyrtarë administrativë nga nivelet e ndryshme qeverisëse, përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar, qytetarë me aftësi të kufizuara, të moshuar, etj. dhe të hartojë një ligj për ndërtimin dhe shfrytëzimin universal të ndërtesave, ku do të integroheshin kërkesat themelore nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për mundësimin e qasjes në ndërtesa dhe parimet e dizajnit universal.²²

Ministria e Infrastrukturës dhe e Mjedisit ta rishikojë Ligjin për Ndërtimin dhe të shtojë dispozita për eliminimin e barrierave arkitektonike në mjedisin e ndërtuar.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të ligjeve vjetore të buxhetit shtetëror, të caktojë një zë të veçantë buxhetor për përmirësimet infrastrukture, me qëllim të eliminimit të barrierave arkitektonike.

Komuna të formojë komisionet e përbëra nga profesionistë të ndërtimit dhe përfaqësues të komunitetit të personave me aftësi të kufizuar për evidencimin e barrierave arkitektonike në ndërtesa shumëbanesore dhe të banimit të përkohshëm (për studentë, për të moshuar dhe banimit social).

²² Basha R. dhe Handikos, Raport i vlerësimit të qasshmërisë së ndërtesave shkollore të nivelit fillor dhe të mesëm ulët për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë, Handikos, 2020, <https://handi-kos.org/raporti-i-vleresimit-te-qasshmerise-se-ndertesave-shkollore-te-nivelit-fillor-dhe-mesem-te-ulet-per-femijet-me-aftesi-te-kufizuara-ne-kosove/> (qasur më, 05.12.2022)

Komuna të hartojë një instrument vlerësues, që do të bazohet në nenet e Udhëzimit Administrativ 33/2007, dhe i cili ndër të tjera, do të përmbante edhe zgjidhjet dizajnuese dhe kostot e intervenimeve përmirësuese, që kanë për qëllim largimin e barrierave arkitektonike në ndërtesat e banimit.

Komuna të inkuadrojë përfaqësues të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në komisione vlerësimi të projekteve publike të banimit (banimi social, konvikte, shtëpi për të moshuar), komisione të pranimeve teknike për projektet e ndërtesave të banimit, për të siguruar përfaqësimin e interesave të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara dhe zbatimin e rregulloreve teknike për qasje fizike të papenguar dhe lëvizje të lirë në këto ndërtesa.

Shoqëria civile të vazhdojë presionin qytetar ndaj institucioneve qendrore dhe lokale për të siguruar zbatimin e rregulloreve dhe kuadrit ligjor në përgjithësi, që mundëson integrimin e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, etj.


Shoqëria civile të lehtësojë dhe ndërmjetësojë komunikimin ndërmjet pushtetit lokal dhe komunitetit të personave me aftësi të kufizuar në lidhje me nevojat dhe problemet e qasjes në mjedis të ndërtuar.

Rekomandime grafike për zgjidhjet teknike të problemeve më kritike të hasura gjatë hulumtimit



Rekomandimet e mëposhtme teknike të paraqitura me skica, përmbledhin disa praktika të mira të dizajnit gjithpërfshirës dhe bazohen në dokumentet vijuese:



1. MMPH, Udhëzimin Administrativ 33/2007, Për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara
2. Meuser, Ph. Accessibility and Wayfinding: Construction and Design Manual, DOM Publishers, 2019
3. Goldsmith S., Universal Design – A Manual of Practical Guidance for Architects, Architectural Press, 2000
4. Habiteng, Wheelchair Housing Design Guide, 3d Edition, 2018

Parkingjet e qasshme për persona me aftësi të kufizuara



Rekomandohet që për çdo ndërtesë shumëbanesore të parashihen parkingje për persona me aftësi të kufizuara ashtu siç parashihen me U.A. 33/2007, 5% të vendparkimeve të përgjithshme. Këto parkingje rekomandohet të vendosen në afërsi të hyrjeve









Rampat


Rekomandohet që të gjitha hyrjet në ndërtesa të banimit shumëbanesor të bëhen të qasshme për persona me aftësi të kufizuara përmes rampave ose platforma ngritëse (varësisht prej lartësisë së hyrjes nga niveli i terrenit). Rampat të punohen sipas kushteve që parashihen në dispozitat e U.A. 33/2007.

Në rastet e rampave ekzistuese, që rezultojnë të paqasshme për shkak të pjerrtësisë së madhe, për shkak të mungesës së gardheve, a ndonjë parametri tjetër, rekomandohet përmirësimi i këtyre parametrave në përputhshmëri me standardet.



Rekomandohet që në brendi të ndërtesave shumëbanesore, përgjatë shkallëve të hyrjeve dhe atyre të brendshme të parashihen gardhe të projektuara në përmasa dhe formë që do të lehtësonin komunikimin nëpër shkallë për persona që kanë vështirësi të lëvizjes në këmbë. Gardhi i shkallëve duhet të jetë në dy lartësi, në mënyrë që t'ua lehtësojnë personave me lartësi të ndryshme që të ngjiten shkallëve pa problem.










Rekomandohet që dorëzat e dyerve të jenë madhësisë dhe formës që janë lehtë të përdorëshme nga personat me aftësi të kufizuara.

Ashensorët


Rekomandohet që gjatë projektimit të ndërtesave të reja të banimit shumëbanesor të instalohen ashensorë që për nga përmasat dhe pajisja i plotësojnë kriteret e përshkruara sipas U. A. 33/2007. Po ashtu, rekomandohet, që te ndërtesat banesore të ndërtuara para vitit 1999, që janë të etazhitetit mbi 4 kate, nëse ka hapësirë, të instalohen ashensorë sipas përshkrimeve në dispozitat e U.A. 33/2007. Në pamundësi të këtij intervenimi, të planifikohet instalimi i platformës pa-losëse në shkallë.



Disa praktika të mira të vendosjes së ashensorëve në raport me komunikatat horizontale.




Kapërcimi i disniveleve të brendshme përmes instalimit të platformës palosëse.




Hyrja në ndërtesë dhe erëmbrojtësi


Rekomandohet që dyert e hyrjes në ndërtesë të dimensionohen sipas parametrave të U.A. 33/2007 (gjerësia e derës hyrëse në ndërtesë së paku 110/210 cm – një krah, ose 2 x 90/210 cm – dy krahëshe). Disa forma të realizimit të dyerve të hyrjes në ndërtesë shumëbanesore janë si më poshtë:



Rekomandohet që erëmbrojtësi të ketë minimum 240 cm thellësi.




Rekomandohet eliminimi i pragjeve te dyert e hyrjes, ose ulja e tyre nën 25 mm. Një shembull i pragut të ulët të dyert hyrëse është i ilustruar në grafikën në të djathtë.




Korridoret e ndërtesës shumëbanesore


Rekomandohet që gjerësitë e korridoreve ndërmjet banesave të jenë minimum 150 cm. Më poshtë është e ilustruar mënyra se si e kufizojnë ose mundësojnë gjerësitë e ndryshme të korridoreve kthimin e karrocave.



Gjerësitë e ndryshme hapësinore të nevojshme për persona me aftësi të kufizuara, por edhe lëvizjen e prindërve me karroca foshnjesh, etj.






Pozita të ndryshme të qasjes së personit me karrocë kundrejt derës së njësisë banesore.



Rekomandohet që lartësia e ndërprerësve të dritës dhe të ziles në korridore të mos jetë më e madhe se 90 cm.


Shembulli i vendosjes së kutisë postare në lartësi adekuate.

Shembulli i realizimit të dritares me dorëz të qasshme nga personi me karrocë.






Praktika të mira të përshtatjes së mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm për qasje të personave me aftësi të kufizuara

Shembulli i një hyrjeje të paqasshme për persona me aftësi të kufizuara fizike, për persona të verbër dhe me dëmtime në shikim.




Shembull (në plan dhe aksonometri) i një hyrjeje dhe rrethinës së saj imediate të përshtatur për të qenë e qasshme për persona me aftësi të kufizuara fizike dhe personave të verbër dhe me dëmtime në shikim.







Shembulli i një korridorit të paqasshëm të ndërtesës së banimit.



Shembulli i përshtatjes së korridorit me ashensor dhe pajisja e korridorit dhe shkallëve me gardhe qasëse, fusha taktore dhe shirita kontrastues në basamakë.



Shembull i kapërcimit të disniveleve me platforma palosëse në brendi të korridoreve të ndërtesës së banimit, si dhe pajisja e korridoreve me fusha taktore dhe elemente të tjera qasëse.



Referencat:

- 1 Basha R. Dhe Çeku H., Standardet ndërkombëtare mbi çështjet e aftësisë së kufizuar – Ku qëndron Kosova?, Vlerësim i legjislacionit të Kosovës në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuar në raport me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Handikos, 2020, http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/05/Report_SHQ-29_04_20_95548.pdf
- 2 Basha R. dhe Handikos, Raport i vlerësimit të qasshmërisë së ndërtesave shkollore të nivelit fillor dhe të mesëm ulët për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë, Handikos, 2020, <https://handi-kos.org/raporti-i-vleresimit-te-qasshmerise-se-ndertesave-shkollore-te-nivelit-fillor-dhe-mesem-te-ulet-per-femijet-me-aftesi-te-kufizuara-ne-kosove/>
- 3 Basha R., Hapësira publike për të gjithë, konceptet e përgjithshme, Qendra Multimedia, 2021
- 4 Basha R., Hapësira publike për të gjithë, rasti i Prishtinës dhe Prizrenit, tezë doktore (2019), <https://upt.al/artikuj-shkencore/1097-fau-hapesira-publike-per-te-gjithe-rasti-i-prishtines-dhe-i-prizrenit>
- 5 Basha R., Raporti i hulumtimit mbi barrierat arkitektonike në ndërtesat publike "Prishtina për të gjithë", nëntor 2016, Handikos dhe GIZ
- 6 Coleman R., Lebbon C., Introduction from Margin to Mainstream, në Clarkson, Coleman R., Keates S., Lebbon C. (Eds.), Inclusive Design: Design for the Whole Population, Springer-Verlag Ltd., London, 2003
- 7 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, <http://www.ohchr.org/en/issues/pages/whatarehumanrights.aspx>
- 8 Goldsmith S., Universal Design – A Manual of Practical Guidance for Architects, Architectural Press, 2000
- 9 Greed C., Inclusive Urban Design: Public Toilets, Routledge, 2003
- 10 Habiteng, Wheelchair Housing Design Guide, 3d Edition, 2018
- 11 Handikos, Plani i Veprimit për PAK në Komunën e Prishtinës, <https://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2018/09/Plani-i-Veprimit-per-PAK-ne-komunen-e-Prishtines-2018-2020.pdf>
- 12 How to Design and Promote an environment accessible to all, Policy Paper, Handicap International, 2009, http://www.hiproweb.org/uploads/tx_hidrtdocs/AccessibilityBD_01.pdf,
- 13 Jackson M A, Models of Disability and Human Rights: Informing the Improvement of Built Environment Accessibility for People with Disability at Neighbourhood Scale?, MDPI, Laws, 2018, 7(1), 10, <https://doi.org/10.3390/laws7010010>
- 14 Ligji nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx-?ActID=10924>

- 15 Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit nr. 03/L-164 dhe aktet nënligjore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>
- 16 Ligji për Ndërtim, nr. 04/L-110, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2833>
- 17 Ligji për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L174, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 30/2013)
- 18 Meuser, Ph. Accessibility and Wayfinding: Construction and Design Manual, DOM Publishers, 2019
- 19 Minci F., Prizreni, Qytet që nuk i kanë mënjauar barrierat për PAK, publikim online nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK, ATRC dhe USAID, fq. 9, <http://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2018/09/Prizreni-qytet-qe-nuk-i-ka-menjanuar-barrierat.pdf>, (qasur më, 24.01.2019)
- 20 OJQ HANDIKOS (edituar nga Osman Shatri), Përmbledhje e legjislacionit mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, http://handi-kos.org/repository/-docs/PERMLEDHJE_LEGJISLACION-I_MBI_TE_DREJTA_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE_KUFIZUARA_628624.pdf,
- 21 Rregullore MMPH 03/2016, Për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13054>
- 22 Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023, <https://handi-kos.org/strategjia-nacionale-per-te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-ne-republiken-e-kosovea-2013-2023/>
- 23 Udhëzimi administrativ i MMPH-së nr. 06/2017 – Për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimimi për Kategorinë I dhe II të Ndërtimeve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14823>
- 24 Udhëzimin Administrativ 33/2007, Për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480>
- 25 WHO Housing and Health Guidelines (2018), <https://apps.who.int/iris/handle/10665/276001>

Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëri – EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion.
2. Aktivizmi – Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës.
3. Orientimi drejt rezultateve – Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura.
4. Komuniteti bazë e veprimit – EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

